



PRAKTIKAT E ORGANIZIMIT TË DËGJIMEVE BUXHETORE NË VITIN 2022 PËR NËNTË (9) KOMUNAT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

TETOR 2022





Instituti Demokratik I Kosovës është degë e
Transparency International për Kosovë

Misioni i KDI-së është mbështetja e
zhvillimit të demokracisë pjesëmarrëse
dhe luftës kundër korrupsion përmes
promovimit të transparencës,
llogaridhënies dhe integritetit në të
gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë

COPYRIGHT © 2022. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 237,
10000, Prishtinë, Kosovë.

Tel.: +381 (0)38 248 038

E-mail: info@kdi-kosova.org

Web: www.kdi-kosova.org

Bartësit e hulumtimit: Naim Cahanaj & Elmedina Dorambari

Hulumtues terreni: Kenan Gashi, Almedin Fejza, Fatbardha Haxhiu, Amir Jakupi, Valerina Smakaj, Gentiana Zeqiri, Mehrreme Krasniqi, Ardiana Tusha, Adem Lushaj.

Layout and design: **envinion**

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Olof Palme International Center (OPC), Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

PËRMBAJTJA

06

1 HYRJE

Qëllimi

Metodologjia – Metodat

07

2 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

09

3. PRAKTIKAT E ORGANIZMIT TË DËGJIMEVE BUXHETORE NË VITIN 2022

Komuna e Prishtinës

Komuna e Prizrenit

Komuna e Ferizajt

Komuna e Mitrovicës së Jugut

Komuna e Kamenicës

Komuna e Skenderajt

Komuna e Rahovecit

Komuna e Kaçanikut

30

4. REKOMANDIMET PËR KOMUNA

32

5. BURIMET

1. HYRJJE

Qëllimi

Sipas OKB-së, pjesëmarrja qytetare nënkupton përfshirjen e qytetarëve në një gamë të gjërë aktivitetesh vendimarrëse, për t'i orientuar programet qeveritare drejt nevojave të komunitetit, për të ndërtuar mbështetjen e publikut dhe për të ndërtuar një ndjenjë kohezioni përbrenda komunitetit¹. Korniza ligjore aktuale në Kosovë, obligon komunitetët t'i informojnë *qytetarët e komunës për çfarëdo planesh apo programesh të rëndësishme me interes publik, siç rregullohet me statutin e komunës*². Po ashtu, projekt-buxheti i komunës për vitin vijues, si dhe rishikimin buxhetor, Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) për 3 vitet e ardhshme, mbasin dokumente ku komunitetët obligohen t'a konsultojnë publikun/qytetarët³.

Hulumtimi i tillë ka për qëllim të jep një pasqyrë më të gjerë në lidhje me gatishmërinë e komunave në respektimin e legjislacionit lidhur me organizimin e dëgjimeve buxhetore gjatë vitit 2022, formën dhe mënyrën e organizimit të dëgjimeve buxhetore në nëntë komuna të Republikës së Kosovës (Prishtinë, Prizren, Mitrovicë e Jugut, Ferizaj, Skenderaj, Deçan, Kaçanik, Kamenicë dhe Rahovec) duke përfshirë: numrin e përgjithshëm të mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, kërkesat dhe natyrën e kërkesave të dhëna nga qytetarët në kuadër të dëgjimeve buxhetore, forma dhe mënyra e përfshirjes së kuvendit të komunës në organizimin e dëgjimeve buxhetore, numri i pjesëmarrësve në dëgjimet buxhetore (disagreguar në baza gjinore), përpilimi dhe publikimi i raporteve nga dëgjimet buxhetore, qasja e komunave në përfshirjen e grupeve të cënueshme në planifikimin e buxhetit komunal.

Metodologjia – Metodrat

Ky hulumtim është realizuar në 9 komunitet të Republikës së Kosovës gjatë periudhës korrik – shtator 2022. Procesi i mbledhjes së të dhënave për 9 komunitet të Kosovës, ka ndjekur një metodologji standarde duke shfrytëzuar metodat adekuat për mbledhjen e të dhënave. Kryesisht, janë monitoruar disa prej dëgjimeve buxhetore të organizuara nga ana e komunave gjatë kësaj periudhe, janë monitoruar uebfaqet zyrtare të komunave lidhur me respektimin e legjislacionit për organizimin dhe mbajtjen e dëgjimeve buxhetore, janë analizuar dhe monitoruar rrjetet sociale të komunave në njoftimin dhe pasqyrimin e përgjithshëm të procesit të organizimit të dëgjimeve buxhetore.

Hulumtimi, është realizuar nga konsorciumi i OJQ-ve "Aleanca Qytetare për Transparencë" i përbërë nga Instituti Demokratik i Kosovës dhe nëntë (9) organizata lokale partnere: OJQ Mundësia, OJQ Fortesa, Iniciativa Qytetare Skenderaj (IQS), Forumi i Organizatave Jo-qeveritare Kaçanik (FOJK), Shoqata e Intelektualëve të Pavarur (SHIP), SHL-Kosova, Rrjeti i OJQ-ve AVONET, Initiative for Social Education – ISEP si dhe OJQ SOFRA.

1 Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi (IDRA). Udhërrëfyes për përfshirjen e qytetarëve / komuniteteve në qeverisjen vendore. Qasja në ueb: <https://www.idrainstitute.org/files/UDHERREFYESI.pdf>

2 Neni 68 paragrafi 3 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

3 Instituti Demokratik i Kosovës (KDI). Buxheti me pjesëmarrje – Sfidat edhe mundësitë e praktikave të mira të buxhetimit me pjesëmarrje në qeverinë lokale në Kosovë. Linku për qasje: <https://kdi-kosova.org/ep-content/uploads/2022/06/16-Report-Policy-Brief-Buxhetimit-me-pjesemarrje-WEB.pdf>

2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Përveç dy takimeve publike, komuna obligohet të mbajë edhe takime tjera konsultative në kuadër të lagjeve, vendbanimeve dhe lokacioneve tjera për çështje që lidhen me buxhetin e komunës, projektet e komunës, zhvillimin ekonomik lokal etj.⁴. Po ashtu UA 06/2018 i obligon komunat/ekzekutivin e komunës të ofroj konsultimin publik edhe për projekt-buxhetin e komunës si dhe për Kornizën Afatmesme Buxhetore për 3 vitet e ardhshme (KAB)⁵. Gjatë monitorimit të procesit të organizimit të dëgjimeve buxhetore, janë dy komuna përkatësisht ajo e Skenderajt dhe e Deçanit, të cilat ekzekutivët e tyre nuk kanë organizuar dëgjime buxhetore për projekt buxhetin e komunës për vitin 2023, para se projekt buxheti i komunës të dorëzohet tek kuvendi i komunës nga ana e kryetarit.

Një nga të gjeturat tjera të monitorimit të organizimit të dëgjimeve buxhetore, mbetet mos përfshirja e kuvendit të komunës në planifikimin e projekt buxhetit të komunës. Meqenëse kryetari i Komunës obligohet që deri me 1 shtator të vitit përkatës fiskal, ta dorëzoj projekt buxhetin tek kuvendi i komunës, ky i fundit mbetet i obliguar të mbajë së paku një dëgjim buxhetor me qytetarët e komunës krahas organizimeve të dëgjimeve buxhetore të realizuara më parë nga ekzekutivi i komunës, kryesisht gjatë muajve korrik dhe gusht⁶. Në këtë kontekst, kuvendi i komunës së Prishtinës, Kamenicës si dhe Skenderajt nuk kanë qenë pjesë e angazhimit në përmbushjen e obligimeve ligjore për tu përfshirë në planifikimin e buxhetit komunal, ashtu edhe siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi.

Komunat mbeten të obliguara të shpallin rezultatet e procesit të konsultimit publik, të publikoj raportin me të gjitha propozimet e ofruara nga qytetarët, si dhe të jap sqarimet e nevojshme lidhur me arsyet e refuzimit të kërkesave të qytetarëve apo grupeve të tjera të interesit⁷. Gjatë procesit të monitorimit të organizimit të dëgjimeve buxhetore në nëntë (9) komunat e Kosovës, komuna e Prizrenit, Rahoveci dhe Kamenica janë në mesin e komunave të cilat e kanë hartuar dhe publikuar raportin me kohë nga organizimi i dëgjimeve buxhetore duke dhënë edhe arsyeshmërinë e pranimit apo refuzimit të kërkesave të qytetarëve të dhënat gjatë organizimit të dëgjimeve buxhetore, derisa komuna e Ferizajt dhe Kaçanikut e kanë përpiluar raportin e tillë por nuk e kanë publikuar në kohë, komuna e Mitrovicës së Jugut dhe Deçanit kanë përpiluar dhe publikuar raportin nga organizimi i dëgjimeve buxhetore por raporti i tillë nuk i përmban elementet përmbajtësore të cilat kërkohen me Udhëzimin Administrativ për standardet minimale të konsultimit publik në nivel lokal derisa komuna e Prishtinës dhe e Skenderajt një obligim të tillë ligjor nuk e kanë përmbushu.

Organi propozues duhet të ofroj kushte për zhvillimin e konsultimit publik me shkrim dhe në formë elektronike, duke përfshirë informimin me kohë për mënyrat dhe afatet e konsultimit publik⁸. Gjatë organizimit të dëgjimeve buxhetore, komuna e Prizrenit, Rahovecit, Kaçanikut, Deçanit dhe e Ferizajt kanë ofruar mundësi për qytetarët për të dhënë komente dhe sugjerime për projekt buxhetin e komunës duke ofruar në dispozicion email adresa zyrtare derisa komuna Kamenicës, Skenderajt, Mitrovicës së Jugut dhe ajo e Prishtinës nuk kanë ofruar një mundësi të tillë për qytetarët,

4 Neni 11 i UA Nr.03/2020 për transparencë në komune, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=31852>

5 Shih nenin 6 paragrafi 1.2 dhe 1.3 i Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18425>

6 Shih nenin 61 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-48 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116, Nr.04/L-194 dhe Nr.05/L-063, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12387>

7 Neni 5 paragrafi 5 i Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18425>

8 Shih nenin 15 paragrafin 1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18425>

që kërkesat apo sugjerimet e tyre t'i dërgojnë edhe në forma të tilla alternative përmes emailave zyrtarë të publikuar.

Derisa legjislacioni obligon grupin punues të bëjë shqyrtimin e komenteve për projekt buxhetin e komunës si dhe vendos për pranimin ose refuzimin e rekomandimeve të marra nga palët e interesuara⁹, janë disa komuna të cilat nuk e kanë formalizuar me vendim grupin punues për përgatitjen e projekt buxhetit të komunës për vitin 2023. Në mesin e komunave që kanë formalizuar me vendim grupin punues për përgatitjen e draft buxhetit të komunës janë ajo e Prizrenit, Rahovecit, Kamenicës dhe e Ferizajt, ndërsa komunat të cilat nuk e kanë formalizuar me vendim grupin punues për përgatitjen e projekt buxhetit të komunës është komuna e Prishtinës, Mitrovicës së Jugut, Skenderajt, Deçanit dhe Kaçanikut.

Organi propozues është i obliguar që raportin e konsultimit publik të paraqes në kuvendin e komunës para aprovimit të projekt propozimit¹⁰. Gjatë procesit të monitorimit të organizimit të dëgjimeve buxhetore, janë dy komuna të cilat e kanë dërguar raportin e konsultimit publik tek kuvendi i komunës (komuna e Prizrenit dhe Kamenicës), derisa 7 komuna të tjera që janë pjesë e hulumtimit / monitorimit të organizimit të dëgjimeve buxhetore nuk kanë dorëzuar raportin e tillë tek anëtarët e kuvendit të komunës, si pjesë përcjellëse e materialit e pikës së rendit të ditë për projekt buxhetin e komunës për vitin 2023.

Komunat gjatë procesit të planifikimit të organizimit dhe mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, kanë synuar gjithë-përfshirjen e grupeve specifike duke përfshirë dëgjime buxhetore me OSHC-të nga fushat e ndryshme, dëgjime buxhetore më personelin arsimor, shëndetësor, dëgjime buxhetore me gra, me shoqatat e biznesit etj. Në mesin e 9 komunave të monitoruara, vetëm komuna e Ferizajt nuk ka planifikuar dhe mbajtur dëgjime buxhetore enkas me grupe specifike derisa numër me të madh të organizimeve të dëgjimeve buxhetore me grupe specifike ka organizuar komuna e Kamenicës.

Komunat e monitoruara gjatë procesit të organizimit të dëgjimeve buxhetore, kanë planifikuar dhe mbajtur numër të ndryshëm të dëgjimeve buxhetore. Në këtë kontekst prinë komuna e Kamenicës e cila ka realizuar gjithsej 20 dëgjime buxhetore për projekt buxhetin e vitit 2023 derisa komuna më me pak organizime të dëgjimeve buxhetore ishte komuna e Rahovecit me vetëm 4 organizime buxhetore për projekt buxhetin e komunës për vitin 2023.

⁹ Neni 17 i Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18425>

¹⁰ Neni 17 paragrafi 5 dhe 6 i Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18425>

3. PRAKTIKAT E ORGANIZMIT TË DËGJIMEVE BUXHETORE NË VITIN 2022

Komuna e Prishtinës

Fillimit të planifikimit të buxhetit të komunës i ka parapri diskutimet brenda institucionale me qëllim të koordinimit dhe finalizimit të procesit të dëgjimeve buxhetore. Përkundër mungesës së vendimit për formalizimin e grupit punues për planifikimin e projekt buxhetit të komunës për vitin 2023, bartës të planifikimit dhe organizimit të dëgjimeve buxhetore në komunën e Prishtinës kanë qenë drejtorja për financa dhe zyra e kryetarit të komunës, ku dhe kanë përpiluar dhe publikuar orari i organizimit dhe mbajtjes së dëgjimeve buxhetore për projekt buxhetin e vitin 2023¹¹. Vlen të theksohet se një numër i vogël i anëtarëve të kuvendit të komunës ishin pjesëmarrës gjatë organizimit të dëgjimeve të tilla buxhetore.

Ekzekutivi i komunës së Prishtinës gjatë procesit të organizimit të dëgjimeve buxhetore, në Planin e saj kishte paraparë të mbaj pesë (5) dëgjime buxhetore, në sallën e mbledhjeve të kuvendit të komunës në Prishtinë. Të organizuara nga ekzekutivi i komunës, disa nga anëtarët e kuvendit të komunës kanë marrë pjesë në këto organizime buxhetore, derisa gjatë muajit shtator kuvendi i komunës së Prishtinës nuk ka arritur të përmbushë obligimin ligjor që të organizojë enkas edhe një dëgjim buxhetor me qytetarë.

Në kuadër të Planit dhe publikimit të orarit për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore, Komuna e Prishtinës ka synuar gjithë-përfshirjen e grupeve qytetare për të qenë pjesë e planifikimit të buxhetit komunal. Në këtë kontekst, kjo komunë kishte parapa një (1) dëgjim buxhetor me OSHC nga fushat e ndryshme Sportive, Kulturore, Rinia dhe fusha Sociale, një (1) dëgjim buxhetor me drejtorët e arsimit para fillor, fillor dhe të mesëm të komunës së Prishtinës, një (1) dëgjim buxhetor me personelin shëndetësor QKMF, QMF të komunës së Prishtinës, një (1) dëgjim buxhetor me kryetarët e bashkësive, lagjeve dhe fshatrave të komunës së Prishtinës dhe një (1) dëgjim buxhetor me anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe përfaqësuesit e tyre të lagjes apo me gjerë.

inës dhe një (1) dëgjim buxhetor me anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe përfaqësuesit e tyre të lagjes apo me gjerë.

Gjatë fazës të organizimit të dëgjimeve buxhetore, komuna e Prishtinës nuk ka ofruar në dispozicion qytetarëve të saj mundësi alternative të pjesëmarrjes në vendimmarrje të planifikimit të buxhetit komunal për vitin 2023. Bazuar në kornizën ligjore, komunat obligohen të ofrojnë mundësi alternative qytetarëve për tu përfshirë në planifikimet e politikave, konkretisht obligohen të ofrojnë në dispozicion email adresa zyrtare si mundësi për ti dërguar komentet, sugjerimet apo kërkesat për politikat që zhvillohen në nivel lokal. Komuna e Prishtinës ka anashkaluar obligimet e tilla ligjore duke mos ofruar mundësi të tilla inovative për qytetarët, por fokusi i saj ishte në sigurimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në planifikimin e buxhetit për vitin 2023 vetëm me prezencë fizike.

Nga pesë (5) dëgjimet buxhetore të organizuara nga komuna e Prishtinës, kanë marrë pjesë gjithsej 118 persona, nga të cilët 85 meshkuj dhe 33 gra. Pjesëmarrja e qytetarëve në organizimet e dëgjimeve buxhetore ishte në mesataren prej 23 personave për dëgjim buxhetor, numër ky i vogël i pjesëmarrjes së qytetarëve krahasuar me numrin e banorëve që ka komuna e Prishtinës.


Numri i përgjithshëm i mbajtjes së takimeve (dëgjimeve buxhetore) dhe vendet ku janë mbaj?



11 Shih orarin e dëgjimeve publike, https://prishtinaonline.com/uploads/orari_i_diskutimeve.pdf




Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në dëgjimet buxhetore i disaagreguar në baza gjinore



Në kuadër të organizimeve të pesë (5) dëgjimeve buxhetore, qytetarët pjesëmarrës kanë parashtruar gjithsej 101 kërkesa për planifikim të buxhetit komunal. Ndër kërkesat kryesore të paraqitura në këto dëgjime buxhetore kryesisht

kanë qenë për infrastrukturë me gjithsej dyzetënëntë (42) kërkesa derisa numër më të vogël të kërkesave për projeksione buxhetore janë parashtruar në lëmin e kulturës me gjithsej katër (4) kërkesa.

Cilat janë kërkesat dhe natyra e kërkesave të dala nga dëgjimet buxhetore



Ekzekutivi i komunës së Prishtinës ka publikuar procesverbale të dëgjimeve buxhetore të mbajtura gjatë muajit gusht 2022¹². Publikimi i procesverbaleve të tilla në uebfaqen e zyrtare të komunës, rrit transparencën e komunës në raport me kërkesat e dhëna nga ana e qytetarëve dhe grupeve të tjera të interesit, pjesëmarrëse në organizime. Mirëpo publikimi i procesverbaleve të tilla nuk e avancoi komunikimin e vazhdueshëm të institucionit me qytetarët, lidhur me informimin e statusit të kërkesave/sugjerimeve të qytetarëve për përfshirjen apo refuzimin e tyre në projekt

buxhetin e komunës për vitin 2023. Për më tepër, mbetet obligim për institucionet përpilimi dhe publikimi i Raportit nga organizimi i dëgjimeve buxhetore, ku në këtë raport duhet të jepen sqarimet e nevojshme lidhur me arsyet e refuzimit të kërkesave të qytetarëve apo grupeve të tjera të interesuara, ku komuna e Prishtinës nuk e ka përpiluar dhe publikuar në uebfaqen e saj zyrtare këtë raport.

12 Për më tepër shih: <https://kk.rks-gov.net/prishtine/kuvendi/ekstraktet-e-procesverbaleve-te-degjimeve-publike/>




Komuna e Prizrenit

Dëgjimet publike në Prizren kanë filluar me vendimin e kryetarit të Komunës për formimin e grupit punues për hartimin e draft buxhetit për vitin 2023¹³. Grupi punues kishte 13 anëtarë, përfaqësues të disa dikastereve duke filluar prej drejtorisë së ekonomisë, financave, shërbimeve publike etj. Po ashtu kryetari i komunës me vendim të posaçëm ka emëruar një zyrtar të drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për zyrtarin përgjegjës për menaxhimin me platformën e konsultimeve publike dhe për koordinimin e dëgjimeve publike¹⁴. Komuna e Prizrenit në fillim të procesit e ka publikuar kalendarin dhe planin e dëgjimeve publike në ueb faqen e Komunës bashkë me draft buxhetin e Komunës¹⁵¹⁶.

Krahas planifikimit të dëgjimeve buxhetore me prezencë fizike, komuna e Prizrenit ka synuar që projekt buxheti i vitit 2023 të jetë në konsultim edhe përmes formave alternative / elektronike, duke u dhënë mundësi qytetareve të kenë qasje në draft buxhetin e komunës si dhe duke ofruar mundësi që kërkesat e tyre për projekt buxhetin e vitit 2023, ti dërgojnë edhe në formë elektronike, duke lënë në dispozicion tri (3) email adresa të zyrtarëve komunal¹⁷. Aktëretë kyç në planifikimin, organizimin dhe mbajtjen e dëgjimeve buxhetore të realizuara në muajin gusht 2022, ishin drejtoria për buxhet dhe financa dhe zyra për informim derisa gjatë mbajtjes së dëgjimeve buxhetore në lokalitet të ndryshme, kishte pjesëmarrje edhe të anëtarëve të kuvendit të komunës së Prizrenit.

Ekzekutivi i komunës gjatë muajit gusht ka organizuar nëntë (9) dëgjime buxhetore në vende të ndryshme të rajonit të Prizrenit. Mënyra e organizimit të dëgjimeve buxhetore ishte e fokusuar në rajone, duke organizuar në një vend dëgjimin buxhetor për disa lagje apo fshatra të atij rajonit. Në kuadër të planifikimit të dëgjimeve buxhetore, ishin në fokus grupet specifike, duke organizuar dëgjime buxhetore me gra, me organizatat e shoqërisë civile shoqatat e biznesit, klubet sportive dhe organizatat kulturore.

Numri i përgjithshëm i mbajtjes së takimeve (dëgjimeve buxhetore) dhe vendet ku janë mbajtur?



13 Vendimi i Kryetarit të Komunës për formimin e grupit punues për hartimin e draft buxhetit të Komunës, vendimi nr. 01/060-0111493/22 <https://kk.rks-gov.net/prizren/ep-content/uploads/sites/26/2022/08/Vendimi-per-formimin-e-grupit-Punues-per-hartimin-e-Draft-buxhetit-te-Komunes-se-Prizrenit-per-vitin-2023-2025.pdf>

14 Vendimi i kryetarit të komunës për caktimin e menaxherit për koordinimin e procesit të dëgjimeve publike, vendimi nr. 01/060-0086262/22 <https://kk.rks-gov.net/prizren/ep-content/uploads/sites/26/2022/07/Haziz-Krasniqi-zyrtar-pergjegjese-per-menaxhimin-me-platfomen-e-Konsultimeve-Publike.pdf>


15 Plani për organizimin e dëgjimeve buxhetore 2023, <https://kk.rks-gov.net/prizren/ep-content/uploads/sites/26/2022/07/1-Plani-per-organizimin-e-dëgjimeve-buxhetore-per-vitin-2023-PDF.pdf>

16 Kalendarin e dëgjimeve buxhetore për buxhetin e vitit të ardhshëm 2023, <https://kk.rks-gov.net/prizren/ep-content/uploads/sites/26/2022/08/Kalendar-i-dëgjimeve-publike-per-buxhet-per-vitin-2023-SHQ.pdf>

17 Për më tepër shih njoftimin, <https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2022/08/1-Njoftimi-Pirane.pdf>



Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në dëgjimet buxhetore i disaagreguar në baza gjinore




Sipas raportit të komunës, dhe analizimit të procesverbalëve dhe listave të pjesëmarrësve, në dëgjimet buxhetore të organizuara nga ekzekutivi i komunës së Prizrenit kanë marrë pjesë 237 qytetarë, prej tyre rreth 25 gra dhe 212 burra¹⁸. Mesatarja e pjesëmarrjes së qytetarëve në një dëgjim buxhetor ishte 26 pjesëmarrës.

Në kuadër të organizimeve nëntë (9) dëgjimeve buxhetore, qytetarët pjesëmarrës kanë parashtruar gjithsej 318 kërkesa për planifikim të buxhetit komunal, përfshirë edhe kërkesat e parashtruara në formë elektronike. Ndër kërkesat kryesore të paraqitura në këto dëgjime buxhetore kryesisht kanë qenë për infrastrukturë me gjithsej njëqind e tridhjetë e katër (134) kërkesa derisa numër më të vogël

të kërkesave për projeksione buxhetore janë parashtruar në lëmin e bujqësisë me gjithsej katër (4) kërkesa.

Në muajin shtator, kryesuesja e kuvendit të komunës, bashkë me anëtarët e KPF-së ka organizuar enkas edhe një dëgjim buxhetor në sallën e kuvendit komunal për të gjitha qytetaret e Komunës së Prizrenit¹⁹. Realizimi i këtij aktiviteti ka përmbyllur obligimet e kuvendit të komunës si institucion më i lartë vendimmarrës në përfshirjen e planifikimit të buxhetit komunal. Gjatë realizimit të dëgjimit buxhetor nga kuvendi i komunës, nga 9 pjesëmarrës ishin parashtruar 22 kërkesa për projeksione buxhetore. Kërkesat për projeksione buxhetore në infrastrukturë prinin për nga numri me gjithsej 10 kërkesa.

Cilat janë kërkesat dhe natyra e kërkesave të dala nga dëgjimet buxhetore të organizuar nga ekzekutivi i komunës



¹⁸ Raporti i dëgjimeve publike për buxhetin e vitit 2023 i publikuar në ueb faqen e Komunës: <https://kk.rks-gov.net/prizren/ep-content/uploads/sites/26/2022/09/Raporti-me-te-gjitha-detajet-per-gjithe-procesin-e-degjimeve-buxhetore-per-buxhetin-e-vitit-2023.pdf>

¹⁹ Shih Raportin, <https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2022/09/1-Raporti-nga-procesi-i-degjimit-buxhetore-per-projekt-buxhetin-e-komunes-se-Prizrenit-per-vitin-2023-i-organizuar-nga-KPF-ja.pdf>





Cilat janë kërkesat dhe natyra e kërkesave të dala nga dëgjimet buxhetore tër organizuara nga kuvendi i komunës



Të obliguar në mbajtjen e procesverbaleve dhe publikimin e tyre nga organizimi i dëgjimeve buxhetore, ekzekutivi i komunës së Prizrenit ka përmbushur obligimet e tilla ligjore duke i publikuar të gjitha procesverbalet e dëgjimeve buxhetore të mbajtura gjatë muajit gusht 2022²⁰. Po ashtu, grupi punues për planifikimin e buxhetit të komunës ka hartuar dhe publikuar Raportin e dëgjimeve buxhetore, duke dhënë informatat mbi numrin e përgjithshëm të pjesëmarrësve, numrin dhe natyrën e kërkesave të qytetarëve si dhe ka specifikuar statusin e kërkesave të qytetarëve që kanë dal në kuadër të organizimeve buxhetore qoftë me prezencë fizike qoftë me dhënie të mundësisë përmes formave tjera alternative.

Ekzekutivi i komunës së Prizrenit po ashtu ka përmbushur obligimet ligjore në dërgimin e Raportit të dëgjimeve buxhetore të kuvendi i komunës si pjesë e materialit përcjellës për pikat e rendit të ditës, veprim ky i cili është në përputhje me Udhëzimin Administrativ për Standardet minimale të konsultimit publik në komuna.

Gjatë organizimit të dëgjimeve buxhetore me prezencë fizike, ekzekutivi i komunës së Prizrenit nuk ka përmbushur obligimet ligjore për përdorimin e gjuhëve. Në takimet e organizuara në fshatin Reqanë dhe Korishë, ku pjesëmarrës ishin edhe anëtarë të komunitetit boshnjak, komuna nuk ka ofruar përkthim dhe material përcjellës në gjuhët tjera zyrtare (boshnjake), nuk ka arritur ti njoftojnë qytetarët e komunitetit boshnjak në këto lokalitete si dhe kryetareve të bashkësive lokale për mbajtjen e dëgjimit buxhetore. Si shkak i lëshimeve të tilla, pjesëmarrja e qytetarëve nga radhët e komunitetit boshnjak në dëgjimet e tilla buxhetore ishte e ultë, ku si shembull specifik kemi identifikuar mbajtjen e dëgjimit buxhetor në fshatin Reqanë, i cili banohet kryesisht me qytetarë të komunitetit boshnjak, por në dëgjimin buxhetor të mbajtur ishin vetëm tre (3) pjesëmarrës.



Gjatë realizimit të dëgjimit buxhetor nga kuvendi i komunës, nga 9 pjesëmarrës ishin parashtruar 22 kërkesa për projeksione buxhetore. Kërkesat për projeksione buxhetore në infrastrukturë prinin për nga numri me gjithsej 10 kërkesa.

20 Procesverbalet dhe raportet nga takimet e dëgjimeve publike për buxhetin e vitit 2023 <https://kk.rks-gov.net/prizren/degjimet-publike/njoftimet/?page=1>



Komuna e Ferizajt

Procesit të planifikimit të projekt buxhetit të komunës së Ferizajt për vitin 2023 i ka paraprir vendimi i kryetarit të komunës i datës 29.07.2022 për formimin e grupit punues për përgatitjen e projekt buxhetit për vitin 2023. Grupi punues në përbërjen e tij kishte 11 anëtarë dhe kryesisht ishin të përfaqësuar drejtorit komunale të komunës së Ferizajt. Para fillimit të organizmit të dëgjimeve buxhetore, drejtoria për ekonomi dhe Financa ka përgatitur planin e veprimit për organizimin dhe mbajtjen e dëgjimeve buxhetore²¹ derisa akterët kyç në planifikimin, organizimin dhe mbajtjen e dëgjimeve buxhetore të realizuara në muajin gusht 2022, ishte drejtoria për buxhet dhe financa dhe zyra për informim.

Bazuar në të dhënat e monitorimit, komuna e Ferizajt ka planifikuar dhe mbajtur gjithsej dhjetë (10) dëgjime buxhetore, nga dy brenda ditës nga data 2 deri me 6 gusht në këto lokalitete: SHFMU „Ahmet Hoxha”, SHFMU „Astrit Bytyçi”, SHFMU „Jeta e Re”-Greme, SHFMU „Konstandin Kristoforidhi”- Nerodime e Epërme, SHFMU „Besim Rexhepi”-Komogllave, SHFMU „Ramadan Rexhepi”-Sojeve, SHFMU „Bitall Shala”-Llojza, SHFMU „Dy Dëshmorët”-Talinoc i Muhaxhereve, SHFMU „Liman Rekaj”-Surqine, SHFMU „Ganimete Tërbeshi”-Muhovc. Përkundër planifikimit prej 10 organizimeve, komuna e Ferizajt nuk kishte në fokus organizimin e dëgjimeve buxhetore me grupe specifike, posaçërisht me gra dhe grupe tjera të nën përfaqësuar²².

Numri i përgjithshëm i mbajtjes së takimeve (dëgjimeve buxhetore) dhe vendet ku janë mbajt?



Në kuadër të dhjetë (10) organizimeve buxhetore nga ekzekutivi i komunës, pjesëmarrës ishin 101 qytetarë, nga ta 99 ishin burra dhe vetëm 2 gra. Nga të dhënat, del që gratë ishin fare pak pjesëmarrëse në dëgjimet buxhetore, duke bërë që planifikimet buxhetore për vitin 2023 të mos prekin nevojat reale të grave për projeksione buxhetore. Megjithatë, mesatarja e pjesëmarrjes së qytetarëve në 10 organizimet e dëgjimeve buxhetore ishte rreth 10 pjesëmarrës në secilin organizim. Kërkesat e paraqitura nga ana e qytetarëve kanë qenë të natyrave të ndryshme por me të theksuara kanë qenë në sferën e infrastrukturës së përgjithshme, duke përfshirë: ndriçimin publik, rrjetin e kanalizimit, rregullimin e rrugëve të arave, rregullimin e fushave sportive me bari sintetik, rregullimin e trotuareve, investime në kënde të lojërave për fëmijë, asfaltimin e rrugëve të reja, pastrimin e lumenjve, mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit, mbjellja e dorinjve de-


korativ, mirëmbajtja e shtatorëve të dëshmorëve, renovimi i shkollave, ndërtimi i kopshteve për fëmijë, ndërtimi i qendrës të mjekësisë familjare në fshatra etj. Në kuadër të 10 organizimeve të dëgjimeve buxhetore, qytetarët kanë parashtruar vetëm 139 kërkesa për projeksione buxhetore.

Anëtarët e kuvendit fare pak kanë marrë pjesë në dëgjimet buxhetore të mbajtura dhe realizuara gjatë muajit gusht nga ekzekutivi i komunës. Megjithatë, kuvendi i komunës ka përmbushur obligimet e saj ligjore, duke organizuar enkas një (1) dëgjim buxhetor gjatë muajit shtator²³. Komuna ka ofruar mundësi për qytetarët e saj duke i informuar për draft buxhetin e komunës i cili ishte vënë në dispozicion në ueb faqen zyrtare të komunës²⁴. Po ashtu, komuna ka ofruar mundësi dhe forma alternative të përfshirjes së qytetarëve në planifikimin e buxhetit duke ofruar në dispozicion email

21 Shih planin, <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/wp-content/uploads/sites/31/2022/08/Plani-i-veprimit-FINAL-FERIZAJ1-per-buxhet.pdf>
22 Pwr mw tepwr shih raportin, https://kk.rks-gov.net/ferizaj/wp-content/uploads/sites/31/2022/10/raporti-i-ecurise_compressed.pdf?fbclid=IwAR1DqhC-s30PoRwFP1G9tL75SsagTibtz18EtEzFp-1nWz0AG2v2rdgkuo
23 Shih njoftimin e datës 08.09.2022, <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/category/degjimet-publike/>
24 Për më tepër shi draft KAB, <https://konsultimet.rks-gov.net/vieëMeeting.php?MeetingID=65>



Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në dëgjimet buxhetore i disaagerguar në baza gjinore



adresa zyrtare, si mundësi për ti dërguar komentet, sugjerimet apo kërkesat për projeksione buxhetore²⁵.

Komuna e Ferizaj, ka përpiluar raportin nga organizmi i dëgjimeve buxhetore por raportin i tillë e ka publikuar me vonës të theksuar²⁶. Komuna e Ferizajt me datë 06.08.2022 ka mbajtur dëgjimin e fundit buxhetor me qytetarë derisa afati për përgatitjen e Raportit është më së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë dhe jo më shumë se tridhjetë (30) ditë kalendarik nga dita e përfundimit të organizimit buxhetor të fundit. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas përfundimit të raportit nga grupi punues mbi shqyrtimin publik, raporti dërgohet tek zyrtari përgjegjës koordinues i cili obligohet ta publikoj në ueb faqen zyrtare të komunës²⁷. Një hap pozitivë

në publikimin e procesverbaleve nga organizimi i dëgjimeve buxhetore komuna e ka realizuar duke i publikuar të gjithë procesverbalet e tilla në ueb faqen e komunës²⁸.

Përkundër përpilimit të Raportit, ekzekutivi i komunës nuk ka përmbushur obligimet ligjore në dërgimin e Raportit të dëgjimeve buxhetore tek kuvendi i komunës si pjesë e materialit përcjellës për pikat e rendit të ditës. Veprim i këtillë është në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ për Standardet minimale të konsultimit publik në komuna, meqenëse organi propozues i projekt buxhetit të komunës është i obliguar që raportin të paraqes në kuvendin e komunës para aprovimit të projekt propozimit.

Cilat janë kërkesat dhe natyra e kërkesave të dala nga dëgjimet buxhetore të organizuar nga ekzekutivi i komunës



25 Shih njoftimet e komunës :<https://kk.rks-gov.net/ferizaj/category/degjimet-publike/njoftimet-degjimet-publike/>

26 Raporti i publikuar me datë 03.10.2022, https://kk.rks-gov.net/ferizaj/wp-content/uploads/sites/31/2022/10/raporti-i-ecurise_compressed.pdf

27 Shih nenin 17 paragrafi 4 dhe 5 i Udhëzimit Administrative, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18425>

28 Shih procesverbalet, <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/category/degjimet-publike/procesverbale-degjimet-publike/>



Komuna e Mitrovicës së Jugut

Me qëllim të synimit që planifikimi i buxhetit të jetë sa më transparent dhe të merren parasysh kërkesat e qytetarëve si dhe kontributi i tyre në përpilimin e planifikimit të buxhetit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa i ka ndarë takimet në dy modalitet: rurale dhe urbane, në mënyrë që të përfshihen të të gjitha strukturat dhe grupet e interesit. Dëgjimet buxhetore për Draft-buxhetin e vitit 2023 dhe parashikimet e vitit 2024-2025 janë organizuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, përderisa si bartës përkrahës ka qenë Zyra e Kryetarit, anëtarët e Kuvendit, Zyra për informim, Drejtorët e Drejtorive si dhe Zyra për Barazi gjinore²⁹. Orari i dëgjimeve buxhetore është publiku në faqen zyrtare të Komunës së Mitrovicës Jugore, në rrjete sociale, vendet publike dhe media më datë 08.07.2022, ndërsa sekretaria e Kuvendit ka qenë përgjegjëse të informojë përfaqësuesit e fshatrave dhe lagjeve, përderisa Drejtoria për Kulturë dhe Arsim ka qenë përgjegjëse të informoj hapësirat e shkollave për takime. Dëgjimet buxhetore kanë filluar me datë 20.07 dhe kanë përfunduar më 28.07.2022³⁰. Siç edhe është cekur më lartë dëgjimet buxhetore janë mbajtur sipas planit që ishte paraparë por që ka munguar mbështetje e bartëseve institucionale në organizimin e dëgjimeve buxhetore përveç zyrës për informim, TV dhe pjesërisht zyrës për barazi gjinore. Gjithashtu kanë munguar njoftimet nga Sekretaria e Kuvendit për përfaqësuesit e fshatrave dhe lagjeve, gjë e cila ka ndikuar në numër të vogël të pjesëmarrësve.

Në komunën e Mitrovicës Jugore janë mbajtur gjithsej tetë (8) dëgjime buxhetore. Katër (4) dëgjime buxhetore janë mbajtur në lokalitete të ndryshme të komunës dhe katër (4) të tjerë në sallën e kuvendit të komunës. Komuna në planet e saj për organizimin dhe mbajtjen e dëgjimeve buxhetore, kishte target specifik grupe të caktuara qytetarë me qëllim të dhënies së kontributit të tyre për planifikimin e buxhetit të komunës për vitin 2023.

Sipas zyrtares nga drejtoria e financave, numri i përgjithshëm i pjesëmarrjes së qytetarëve në organizimet e dëgjimeve buxhetore ishte 85 persona, ku 22 prej tyre ishin gra dhe 63 të tjerë meshkuj³¹. Pra, nga 8 organizime që kishte planifikuar dhe mbajtur komuna e Mitrovicës së Jugut, pjesëmarrja e qytetarëve në dëgjimet buxhetore ishte në një mestrarë prej 10 persona në një dëgjim buxhetor.

Gjatë procesit të organizimit të dëgjimeve buxhetore, qytetarët kanë parashtruar gjithsej 126 kërkesa për projeksione buxhetore për projekt buxhetin e vitit 2023. Natyra e kërkesave ishte e ndryshme, por kërkesat për intervenime në infrastrukturë ishin më të theksuara me gjithsej 41 kërkesa të tilla derisa ato për kulturë ishin vetëm 8 të tilla.

Numri i përgjithshëm i mbajtjes së takimeve (dëgjimeve buxhetore) dhe vendet ku janë mbajtur



Pjesëmarrja dhe angazhimi i anëtarëve të kuvendit të komunës në mbajtjen e dëgjimeve buxhetore ka qenë minimal, ku në disa takime kanë marrë pjesë, kryesisht anëtarë të kuvendit që ishin edhe banorë të lokalitetit ku po organizohej dëgjimi buxhetor.

Raporti nga dëgjimet buxhetore është publikuar nga ana e Komunës së Mitrovicës së Jugut, ku janë të përfshira informatat kronologjike për numrin e mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, pjesëmarrjen e qytetarëve dhe përgjegjësit institucional në organizimin e dëgjimeve të tilla. Përkundër hartimit dhe publikimit të raportit, raporti i tillë nuk i

²⁹ Shih raportin e dëgjimeve buxhetore, <https://kk.rks-gov.net/mitrovicëejugut/wp-content/uploads/sites/18/2022/08/Raporti-i-Dëgjimeve-Buxhetore-me-qytetar-per-planifikimin-e-buxhetit-2023-2025.pdf>


³⁰ Shih orarin e dëgjimeve: <https://kk.rks-gov.net/mitrovicëejugut/wp-content/uploads/sites/18/2022/07/Orari-i-Dëgjimeve-buxhetore-me-qytetar-per-planifikimin-e-Draft-Buxhetit-per-vitin-2023-2025-1-1.pdf>

³¹ Informatë e dhënë nga zyrtarja e komunës Mevlyde Peci me datë 05.09.2022






Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në dëgjimet buxhetore i disaagerguar në baza gjinore



përmban elementet përmbajtjesore të cilat specifikohen në udhëzimin Administrativ për standardet minimale të konsultimit publik në nivel lokal, duke mos ofruar informatat adekuate për pranimin apo refuzimin e kërkesave të parashtruara nga ana e qytetarëve në kuadër të realizimit të dëgjimeve buxhetore për projekt buxhetin e komunës për vitin 2023³². Sa i përketë procesverbaleve nga organizimi i 8 dëgjimeve buxhetore, komuna e Mitrovicës së jugut ka praktikuar që të dhënat e përgjithshme të përfshihen në "Raport për dëgjimet buxhetore me qytetarë për planifikimin e buxhetit për vitin 2023 - 2025".

Kuvendi i komunës së Mitrovicës së Jugut, në kuadër të ushtrimit të rolit dhe përgjegjësisë në planifikimin e buxhetit të komunës, gjatë muajit shtator ka planifikuar të organizojenkas një dëgjim buxhetor me qytetarët e komunës së Mitrovicës së Jugut³³, ku takimi ishte paraparë të mbahet me datë 22.09.2022 në sallën e mbledhjeve të kuvendit të komunës.

Cilat janë kërkesat dhe natyra e kërkesave të dala nga dëgjimet buxhetore



³² Për më shumë shih raportin, <https://kk.rks-gov.net/mitroviceejugut/wp-content/uploads/sites/18/2022/08/Raporti-i-Degjimeve-Buxhetore-me-qytetar-per-planifikimin-e-buxhetit-2023-2025.pdf>

³³ Shih njoftimin e komunës për organizimin e dëgjimit buxhetor, <https://kk.rks-gov.net/mitroviceejugut/wp-content/uploads/sites/18/2022/09/Lajmerim-Draft-buxheti-per-vitin-2023-diskutim-publik.pdf>



Komuna e Kamenicës

Fillimit të procesit të planifikimit të buxhetit të komunës i ka parapri vendimi i kryetarit të komunës për themelimin e Grupit Punues prej pesë anëtarëve, i cili kishte për obligim të hartoj Planin e veprimit dhe kalendarin e dëgjimeve buxhetore³⁴. Ekzekutivi i komunës së Kamenicës gjatë procesit të organizimit të dëgjimeve buxhetore, në Planin e saj kishte paraparë të mbajë 26 dëgjime buxhetore në shumicën e lo-

kaliteteve të Komunës³⁵. Nëntë (9) organizime të dëgjimeve buxhetore janë planifikuar të mbahen në sallen e kuvendit të komunës, derisa 17 organizime të tjera në objektet shkollore në fshatra të ndryshëm të komunës së Kamenicës.

Numri i përgjithshëm i planifikuar për mbajtjen e takimeve (dëgjimeve buxhetore) me qytetarë



Komuna e Kamenicës, në kuadër të organizimit të dëgjimeve buxhetore për planifikimin e buxhetit për vitin 2023 kishte në fokus edhe grupe specifike për të diskutuar draft buxhetin e komunës si dhe dhënien e mundësisë së grupeve të tilla qytetare për të adresuar kërkesa dhe sugjerime të ndryshme për projeksione buxhetore. Në këtë kontekst, komuna e Kamenicës kishte planifikuar edhe 9 dëgjime të tjera buxhetore me grupe të ndryshme qytetare duke përfshirë mjeket, mësimdhënësit, bizneset, të rinjtë etj³⁶. Pra, në tersi komuna ka planifikuar ti realizojë në tersi 26 dëgjime buxhetore por ka arritur ti mbajë vetëm 20 dëgjime buxhetore³⁷, duke përfshirë ato me qytetarë si dhe me grupet e ndryshme të interesit.

Nga kuadër të 20 dëgjimeve buxhetore të realizuara nga komuna e Kamenicës, kanë marrë pjesë gjithsej 352 persona, nga të cilët 336 meshkuj dhe 16 gra. Pjesëmarrja e qytetarëve në organizimet e dëgjimeve buxhetore ishte në mesataren prej 17 personave për një (1) dëgjim buxhetor. Në kuadër të procesit të organizimit të dëgjimeve buxhetore, komuna e Kamenicës nuk ka arritur të informojë qytetarët e komunës për draft buxhetin e komunës, duke mos e publikuar si të tillë draftin gjatë procesit të organizimit të dëgjimeve buxhetore por në fillim të majit shtator, drafti i projekt buxhetit të komunës për vitin 2023 ishte publikuar në ueb faqen zyrtare të komunës³⁸. Për më tepër, komuna

34 <https://kk.rks-gov.net/kamenice/wp-content/uploads/sites/17/2022/09/30921.pdf>

35 Shih agjendën e dëgjimeve buxhetore, <https://kk.rks-gov.net/kamenice/wp-content/uploads/sites/17/2022/08/Agjenda-e-degjimeve-buxhetore-3.pdf>

36 Shih orarin e takimeve me grupet e interesit, <https://kk.rks-gov.net/kamenice/wp-content/uploads/sites/17/2022/08/Orari-i-takimeve-me-grupe-te-vecanta-te-interesit-1.pdf>


37 Shih orarin e takimeve me grupet e interesit, <https://kk.rks-gov.net/kamenice/wp-content/uploads/sites/17/2022/08/Orari-i-takimeve-me-grupe-te-vecanta-te-interesit-1.pdf>

38 Shih draft buxhetin e komunës të publikuar në fillim të muajit shtator, <https://kk.rks-gov.net/kamenice/wp-content/uploads/sites/17/2022/09/27958-2.pdf>






Numri i përgjithshëm i planifikuar për mbajtjen e takimeve (dëgjimeve buxhetore) me grupe të interesit



e Kamenicës gjatë organizimit të dëgjimeve buxhetore nuk ka arritur të ofrojë qytetarëve mundësi shtesë alternative

(email adresa zyrtare) për të ofruar komente dhe sugjerime për projekt buxhetin e komunës për vitin 2023.

Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në dëgjimet buxhetore i disaagreguar në baza gjinore



Gjatë organizimit të dëgjimeve buxhetore, qytetarët kanë parashtruar 250 kërkesa për projeksione buxhetore. Kërkesat kryesore të paraqitura në këto dëgjime buxhetore kryesisht kanë qenë për infrastrukturë me gjithsej me 135 kërkesa, 33 kërkesa për ambient, 28 kërkesa për shërbime publike, 5 për siguri publike etj.


Gjatë organizimit të dëgjimeve buxhetore nga ekzekutivi i komunës, anëtarët e kuvendit të komunës në një numër shumë të vogël kanë marrë pjesë në dëgjime buxhetore. Kuvendi i komunës së Kamenicës nuk ka arritur të përmbyllë ciklin e obligimeve ligjore në organizimin e dëgjimeve buxhetore, meqenëse gjatë muajit shtator nuk ka ndërmarre aktivitete shtesë në organizimin e së paku një (1) dëgjimi buxhetor me qytetarë për projekt buxhetin e viti 2023³⁹.

39 Shih njoftimin për organizimin e dëgjimit buxhetor nga kuvendi i komunës, <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/>





Cilat janë kërkesat dhe natyra e kërkesave të dala nga dëgjetimet buxhetore



Komuna e Kamenicës e ka publikuar me kohë raportin e dëgjimeve buxhetore i cili përmbajnë numrin e përgjithshëm të takimeve (dëgjimeve buxhetore), numrin e pjesëmarrësve, kërkesat e parashtruara nga të gjitha palët pjesëmarrëse si dhe të përshkruar ka pranimin apo refuzimin e tyre dhe arsyetimet për pranim dhe refuzim të kërkesave⁴⁰. Po ashtu, komuna e Kamenicës ka publikuar të gjitha procesverbalet nga organizmi i dëgjimeve buxhetore të organizuara nga ekzekutivi i komunës në ueb faqen e komunës⁴¹, duke përmbyllë një cikël të rëndësishëm në organizimin e dëgjimeve buxhetore.

Ekzekutivi i komunës së Kamenicës ka përmbushur obligimet ligjore në dërgimin e Raportit të dëgjimeve buxhetore të kuvendi i komunës si pjesë e materialit përcjellës për pikat e rendit të ditës, veprim ky i cili përmbushë obligimet e ekzekutivit që rrjedhin nga Udhëzimi Administrativ për Standardet minimale të konsultimit publik në komuna⁴².

Gjatë organizimit të dëgjimeve buxhetore, qytetarët kanë parashtruar 250 kërkesa për projeksione buxhetore. Kërkesat kryesore të paraqitura në këto dëgjime buxhetore kryesisht kanë qenë për infrastrukturë me gjithsej me 135 kërkesa, 33 kërkesa për ambient, 28 kërkesa për shërbime publike, 5 për siguri publike etj.

sites/23/2022/09/Njoftim-Publik-14.09.2022.pdf

40 Shih Raportin nga organizimi i dëgjimeve buxhetore nga ekzekutivi i komunës, <https://kk.rks-gov.net/kamenice/wp-content/uploads/sites/17/2022/09/30921.pdf>

41 Shih procesverbalet e dëgjimeve buxhetore: <https://kk.rks-gov.net/kamenice/category/konsultime-publike/?page=3>

42 Shih materialet e kuvendit, <https://kk.rks-gov.net/kamenice/category/procesverbalet/>




Komuna e Skenderajt

Komuna e Skenderajt, këtë vit nuk ka mbajtur dëgjime buxhetore dhe të dhënat në këtë raport i referohen dëgjimeve për Kornizën Afatmesme Buxhetore të organizuara gjatë muajit qershor 2022. Numri i përgjithshëm i organizimit të dëgjimeve për KAB është pesë (5), ku dëgjimet e tilla janë

mbajtur në lokalitete të ndryshme të komunës, si në vijim: Prekaz i Epërm, Klinë e Epërme, Qirez, Likoc dhe Runik.⁴³ Organizimi i dëgjimeve buxhetore për KAB janë organizuar nga ekzekutivi, përkatësisht zyra e kryetarit dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa.


Numri i përgjithshëm i mbajtjes së takimeve (dëgjimeve buxhetore) dhe vendet ku janë mbajtur?



Gjatë organizimit të dëgjimeve buxhetore për KAB, komuna e Skenderajt nuk kishte target grupe specifike derisa në kuadër të organizimeve të tilla buxhetore, kanë marrë pjesë

gjithsej 146 qytetarë, por qasja në të dhëna për ndarjen e numrit të pjesëmarrësve sipas gjinisë ishte i pa mundshëm.

Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në dëgjimet buxhetore i disaagreguar në baza gjinore




Natyra e kërkesave të dala nga këto dëgjime është e ndryshme, por dominojnë kërkesat për infrastrukturë, kryesisht trotuar, ndriçim publik dhe vazhdim të rrugicave të

lëna përgjysmë. Konkretisht nga 36 kërkesa të evidentuara në procesverbale, 27 prej tyre janë për infrastrukturë.

⁴³ <https://kk.rks-gov.net/skenderaj/category/konkursej-njoftimet/diskutimet-publike/>



Cilat janë kërkesat dhe natyra e kërkesave të dala nga dëgjimet buxhetore



Anëtarët e Kuvendit Komunal kanë qenë prezentë nëpër këto takime, me theks të veçantë ata anëtarë që vijnë nga fshatrat e atyre bashkësive lokale ku janë mbajtur takimet. Pos në mos organizimin e dëgjimeve buxhetore nga ekzekutivi i komunës gjatë muajit korrik – gusht, edhe kuvendi i komunës nuk e ka përmbushë një obligim të tillë ligjor në organizimin e së paku një dëgjimi buxhetor gjatë muajit shtator, konkretisht pas dorëzimit të projekt buxhetit të komunës nga ekzekutivi në kuvend.

Udhëzimi Administrativ për Standardet minimale obligon sponsorizuesit e akteve dhe politikave që të hartojnë Raporte nga organizimi i konsultimeve publike. Përkundër mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, Komuna e Skenderajt nuk ka përpiluar dhe publikuar një Raport të tillë, megjithëkëtë një hap pozitiv është ndërmarrë në publikimin e procesverbaleve nga organizimi i dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB)⁴⁴.

Ekzekutivi i komunës po ashtu nuk ka procedurë për kuvend Raportin e organizimit të dëgjimeve për KAB, duke pa mundësuar anëtarëve të kuvendit të komunës informatat mbi procesin e organizimit të dëgjimeve buxhetore si dhe kërkesave të parashtruara nga ana e qytetarëve për projeksione të caktuara buxhetore.

Natyrë e kërkesave të dala nga këto dëgjime është e ndryshme, por dominojnë kërkesat për infrastrukturë, kryesisht trotuar, ndriçim publik dhe vazhdim të rrugicave të lëna përgjysmë. Konkretisht nga 36 kërkesa të evidentuara në procesverbale, 27 prej tyre janë për infrastrukturë.

⁴⁴ Shih procesverbalet nga dëgjimet për KAB: <https://kk.rks-gov.net/skenderaj/category/konkursej-njoftimet/diskutimet-publike/>



Komuna e Rahovecit

Fillimit të procesit të planifikimit të buxhetit të komunës i ka parapri vendimi i kryetarit të komunës për themelimin e Grupit Punues prej 7 anëtarëve, ku ndër të tjera kishte obligim në hartimin e projekt buxhetit të komunës së Rahovecit për vitin 2023, të hartojë Planin e brendshëm komunal për mbarrëvajtjen e dëgjimeve buxhetore, të bëjë përgatitjen e njoftimit për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore, të caktoj personin përgjegjës për mbajtjen e procesverbalit gjatë mbajtjes së dëgjimeve buxhetore dhe të behë hartimin e tej në aftin ligjor, të bëjë hartimin e raportit nga dëgjimet buxhetore dhe ta përgatit për ta dërguar në kuvendin e komunës⁴⁵. Në kuadër të organizimit të dëgjimeve buxhetore

nga ekzekutivi i komunës, akter kyç ka qenë Grupi Punues i themeluar derisa pjesëmarrës gjatë mbajtjes së organizimit të dëgjimeve të tilla buxhetore kanë qenë prezent të gjithë drejtorët e drejtorive si dhe kryetari i komunës. Ekzekutivi i komunës së Rahovecit gjatë procesit të organizimit të dëgjimeve buxhetore, në Planin e saj kishte paraparë të mbaj katër (4) dëgjime buxhetore, tri (3) prej të cilave në sallën e mbledhjeve të kuvendit të komunës dhe një (1) në shtëpinë e Kulturës "Mensur Zyberaj" në Rahovec.

Numri i përgjithshëm i mbajtjes së takimeve (dëgjimeve buxhetore) dhe vendet ku janë mbaj?



Në kuadër të procesit të organizimit të dëgjimeve buxhetore, komuna e Rahovecit ka informuar dhe ofruar në dispozicion tek qytetarët draft buxhetin e komunës⁴⁶ si dhe ka ofruar forma alternative të dhënies së komenteve dhe sugjerimeve duke ofruar dy email adresa zyrtare se ku mund të dërgohen komentet/kërkesat e qytetarëve si dhe afatin kohor të dërgimit të komenteve / kërkesave të tilla⁴⁷.

Komuna e Rahovecit, në Planin e saj të organizimit të dëgjimeve buxhetore⁴⁸, kishte synuar gjithë-përfshirjen e grupeve qytetare për të qenë pjesë e planifikimit të buxhetit komunal. Në këtë kontekst, kjo komunë kishte parapa një (1) organizim me OSHC, një (1) organizim me grupet e interesit, një organizim për plotësimin e komponentës së buxhetimit gjinor si dhe një (1) dëgjim përmbledhës me bashkësitë lokale dhe lagjet urbane, me përfaqësues të shkollave dhe rininë.

Nga katër dëgjimet buxhetore të organizuara kanë marrë pjesë gjithsej 96 persona, nga të cilët 66 meshkuj dhe 30 gra. Pra, mesatarja e pjesëmarrjes së qytetarëve në një organizim buxhetor ishte 24 qytetarë për organizim.

Një kuadër të organizimeve buxhetore nga ekzekutivi i komunës, qytetarët kanë parashtruar gjithsej 60 kërkesa, prej të cilave ato në infrastrukturë ishin në numër më të madh me gjithsej 39 kërkesa, derisa numër më të vogël të parashtrimt të kërkesave për projeksione buxhetore ishin në lëmin e shëndetësisë me vetëm 1 kërkesë.

45 Shih vendimin e Kryetarit të Komunës, <https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/08/NRP-2510-02-2022-VEN-DIM-per-caktimin-e-Grupit-Punues-per-hartimin-e-Projekt-buxhetit-te-Komunes-se-Rahovecit-per-vitin-2023-2025.pdf>


46 Shih draft buxhetin e publikuar nga ana e komunës: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/08/PREZENTIMI-I-BUXHETIT-2023.pdf> <https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/08/NJOFTIM-PER-DEGJIM-PUBLIK-ME-OJQ.pdf>

47 Shih njoftimet e komunës; <https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/08/NJOFTIM-PER-DEGJIM-PUBLIK-ME-OJQ.pdf>

48 Shih Planin e organizimit të dëgjimeve buxhetore: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/08/PLANI-I-VEPRIMIT-I-DEGJIMEVE-BUXHETORE-2022.pdf>



Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në dëgjetimet buxhetore i disaagreguar në baza gjinore



Gjatë organizimit të dëgjimeve buxhetore nga ekzekutivi i komunës, anëtarët e kuvendit të komunës në një numër shumë të vogël kanë marrë pjesë në dëgjetime buxhetore. Kuvendi i komunës së Rahovecit ka përmbyllë ciklin e obligimeve ligjore në organizimin e dëgjimeve buxhetore, duke ndërmarrë aktivitete shtesë në organizimin e një (1) dëgjimi buxhetor me qytetarë për projekt buxhetin e viti 2023⁴⁹.

Komuna e Rahovecit e ka publikuar me kohë raportin e dëgjimeve buxhetore i cili përmbajnë numrin e përgjithshëm të takimeve (dëgjimeve buxhetore), numrin e pjesëmarrësve dhe përfaqësimin gjinor, kërkesat e parashtruara nga të gjitha palët pjesëmarrëse si dhe të përshkruar ka pranimin

apo refuzimin e tyre dhe arsyetimet për pranim dhe refuzim të kërkesave⁵⁰. Po ashtu, komuna e Rahovecit ka publikuar të gjitha procesverbalet nga organizimi i dëgjimeve buxhetore të organizuara nga ekzekutivi i komunës në ueb faqen e komunës⁵¹, duke përmbyllë një cikël të rëndësishëm në organizimin e dëgjimeve buxhetore.

Ekzekutivi i komunës së Rahovecit nuk ka përmbushur obligimet ligjore në dërgimin e Raportit të dëgjimeve buxhetore të kuvendi i komunës si pjesë e materialit përcjellës për pikat e rendit të ditës, veprim ky i cili është në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ për Standardet minimale të konsultimit publik në komuna⁵².

Cilat janë kërkesat dhe natyra e kërkesave të dala nga dëgjetimet buxhetore



49 Shih njoftimin për organizimin e dëgjimit buxhetor nga kuvendi i komunës, <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2022/09/Njoftim-Publik-14.09.2022.pdf>

50 Shih Raportin nga organizimi i dëgjimeve buxhetore nga ekzekutivi i komunës, <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2022/09/Raporti-nga-procesi-i-organizimit-te-degjimeve-buxhetore-per-projekt-buxhetin-e-komunes-per-vitin-2023.pdf>

51 Shih procesverbalet e dëgjimeve buxhetore: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/category/degjime-buxhetore-al/procesverbalie-degjime-buxhetore/>

52 Shih materialet përcjellëse për pikat e rendit të ditës për muajin shtator 2022, <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2022/09/Shtator-2022-1.pdf>




Komuna e Kaçanikut

Fillimit të procesit të planifikimit të buxhetit të komunës i ka parapri vendimi i kryetarit të komunës për llogaridhënie ndaj qytetarëve dhe këtë gjë e ka bërë përmes ekzekutivit (secili drejtor ka raportuar dhe marrë pjesë në dëgjimet buxhetore sipas drejtorisë së tij/saj, nuk ka pas vendim të veçantë për formalizimin e Grupit Punues. Zyra për informimit në komunë ka bërë edhe përgatitjen e njoftimit për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore, ka mbajtur procesverbalet gjatë mbajtjes së dëgjimeve buxhetore dhe ka bërë hartimin e tij në afatin ligjor, ka hartuar raportin nga dëgjimet buxhetore dhe ka dërguar në kuvendin e komunës përderisa dëgjimet buxhetore i ka mbajtur ekzekutivi komunal, secili drejtor/eshë ishte përgjegjëse për drejtorinë të cilin i/e drejton dhe kishte llogaridhënie për atë pjesë.

Ekzekutivi i Komunës së Kaçanikut ka pasur në plan të mbajtur shtatë (7) dëgjime buxhetore, prej të cilave po shtatë (7) kanë qenë të organizuara, por në dy (2) prej tyre nuk ka pasur pjesëmarrje me ç' rast nuk janë mbajtur. Ndërkohë, këtë vit komuna ka pasur një Strategji të veçantë të organizimit të dëgjimeve buxhetore, duke mbajtur dëgjime buxhetore me grupe të ndryshme të interesit varësisht nga komuniteti prej nga vijnë.

Numri i përgjithshëm i mbajtjes së takimeve (dëgjimeve buxhetore) nga ekzekutivi dhe vendet ku janë mbajtur



Pas përfundimit të dëgjimeve publike, ekzekutivi i komunës para datës 1 shtator ka përcjellë kuvendit të komunës draft buxhetin për vitin 2023. Me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore, kryesuesi i kuvendit të komunës së Kaçanikut përmes Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) ka organizuar dëgjimin e fundit buxhetorë me qytetarë⁵³. Në kuadër të këtij organizimi të dëgjimit buxhetor nga kuvendi i komunës, është vë re mos pjesëmarrja e vetë anëtarëve të këtij institucioni derisa Drejtoria për Financa ishte pjesë e këtij dëgjimi buxhetor, pasi që kjo drejtori është marrë me organizimin dhe koordinimin e këtyre dëgjimeve buxhetore.

Gjatë organizimit të dëgjimeve buxhetore, komuna e Kaçanikut ka informuar dhe ofruar në dispozicion online (ueb faqe) tek qytetarët draft buxhetin e komunës si dhe ka ofruar forma alternative të dhënies së komenteve dhe sugjerimeve duke ofruar email adresën zyrtare të drejtorit për Ekonomi dhe Financa për mundësin e dërgimit të komenteve/kërkesave nga ana e qytetarëve si dhe afatin kohor të dërgimit të komenteve / kërkesave të tilla⁵⁴.

Në kuadër të organizimit të dëgjimeve buxhetore, kanë marrë pjesë gjithsej 76 qytetarë, nga të cilët 67 burra dhe 9 gra. Pra numri mesatar për një organizim të dëgjimit buxhetor ishte rreth 15 pjesëmarrës, në 45 organizimet e mbajtura nga ekzekutivi i komunës.


Gjatë dëgjimeve buxhetore, qytetarët kanë parashtruar gjithsej 16 kërkesa për projeksione buxhetore. Kërkesat për infrastrukturë prinë për nga numri me gjithsej 8 kërkesa, derisa në 6 kategori tjera kemi vetëm nga një kërkesë dhe në kategorinë e çështjeve ambientale kemi dy kërkesa për çështjen e ndotjes së Lumit Nerodime.

53 Shih ftesën për dëgjimin buxhetor, <https://kk.rks-gov.net/kacanik/wp-content/uploads/sites/14/2022/09/ftese-per-degjim-publik.pdf>

54 Shih njoftimin zyrtar të komunës, <https://kk.rks-gov.net/kacanik/wp-content/uploads/sites/14/2022/07/rap.pdf?fbclid=IwAR1ffEd-14q4RQK6dt4dURabaUTXhWDSBfZgMPKrETJ5oID79Lrrs-MzRopo>



Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në dëgjimet buxhetore i disaagreguar në baza gjinore



Të obliguar në mbajtjen e procesverbaleve dhe publikimin e tyre nga organizimi i dëgjimeve buxhetore, ekzekutivi i komunës së Kaçanikut nuk ka përmbushur obligimet e tilla ligjore duke mos i publikuar procesverbalet e dëgjimeve buxhetore të mbajtura gjatë muajit gusht 2022.

Komuna e Kaçanikut, ka përpiluar raportin nga organizimi i dëgjimeve buxhetore por raportin i tillë e ka publikuar me vonës të theksuar konkretisht me datë 21.10.2022⁵⁵. Komuna e Kaçanikut me datë 06.08.2022 ka mbajtur dëgjimin e fundit buxhetor me qytetarë derisa afati për përgatitjen e Raportit është më së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë dhe jo më shumë se tridhjetë (30) ditë kalendarik nga dita e për-

fundimit të organizimit buxhetor të fundit. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas përfundimit të raportit nga grupi punues mbi shqyrtimin publik, raporti dërgohet tek zyrtari përgjegjës koordinues i cili obligohet ta publikoj në ueb faqen zyrtare të komunës⁵⁶.

Ekzekutivi i komunës së Rahovecit nuk ka përmbushur obligimet ligjore në dërgimin e Raportit të dëgjimeve buxhetore të kuvendi i komunës si pjesë e materialit përcjellës për pikat e rendit të ditës, veprim ky i cili është në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ për Standardet minimale të konsultimit publik në komuna⁵⁷.

Cilat janë kërkesat dhe natyra e kërkesave të dala nga dëgjimet buxhetore



55 Shih raportin e publikuar nga komuna e Kaçanikut, <https://kk.rks-gov.net/kacanik/wp-content/uploads/sites/14/2022/09/Raport-fatL.pdf>

56 Shih nenin 17 paragrafi 4 dhe 5 i Udhëzimit Administrative, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18425>

57 Shih ftesën për mbledhjen e kuvendit të komunës, <https://kk.rks-gov.net/kacanik/wp-content/uploads/sites/14/2022/09/Ftese-09.pdf>



Komuna e Deçanit

Komuna e Deçanit, dëgjimet buxhetore ka filluar t'i organizoj në fillim të shtatorit, të udhëhequra nga kryesuesi i Kuvendit dhe drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet⁵⁸. Këtyre dëgjimeve iu kishin paraprirë edhe dëgjimet e organizuara në maj dhe qershor, ku ishte diskutuar Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB). Për dallim nga dëgjimet buxhetore të KAB-it (ishin mbajtur 4 dëgjime), gjatë muajit shtator janë mbajtur 7 dëgjime buxhetore, ku njëra ishte me iniciativë të "Shoqatës së Intelektualëve të Pavarur" si partnere e KDI-së, ku si fokus grup ishin krijuesit letrar, sportistët individual, artistët e skenës, muzikantët, etj.

Dëgjimet buxhetore janë mbajtur në Sallën e Kuvendit Komunal. Përpos grantit të shëndetësisë dhe arsimit, dëgjime buxhetore janë mbajtur edhe me përfaqësuesit e Këshillave të fshatrave, të OJQ-ve, grupeve joformale të grave, krijues letrar dhe qytetarë pa dallim. Duhet përmendur se dëgjimi buxhetor për grantin e arsimit nuk është mbajtur, ngase punëtorët arsimit nuk iu janë përgjigjur ftesës me arsyetimin se janë në grevë.

Numri i përgjithshëm i mbajtjes së takimeve (dëgjimeve buxhetore) dhe vendet ku janë mbajtur?



Në 7 (shtatë) dëgjimet buxhetore kanë marrë pjesë gjithsej 162 persona, nga të cilët 110 burra dhe 52 gra. Mesatarja e pjesëmarrjes së qytetarëve në organizimin e dëgjimeve buxhetore ishte 23 pjesëmarrës për një organizim, numër ky solid i pjesëmarrjes krahasuar me numrin e banorëve që ka kjo komunë. Vlen të theksohet se në organizimet e dëgjimeve buxhetore, pjesëmarrja e grave ishte relativisht e mirë, duke krahasuar me numrin e përgjithshëm të pjesëmarrjes.


Kërkesat e të pranishmëve ishin varësisht nga targeti i grupeve që kishte për synim komuna për t'i pas pjesë të dëgjimeve buxhetore. Pjesëmarrësit në këto dëgjime buxhetore kishin parashtruar gjithsej 42 kërkesa për projeksione buxhetore. Numër më i madh i kërkesave ishin për rregullimin e infrastrukturës në përgjithësi me gjithsej 18 kërkesa të tilla, dhe numër më i vogël i kërkesave ishte në lëmin e shëndetësisë me vetëm 2 kërkesa.

Në 7 (shtatë) dëgjimet buxhetore kanë marrë pjesë gjithsej 162 persona, nga të cilët 110 burra dhe 52 gra. Mesatarja e pjesëmarrjes së qytetarëve në organizimin e dëgjimeve buxhetore ishte 23 pjesëmarrës për një organizim

⁵⁸ Shih njoftimin e komunës për organizimin e dëgjimeve buxhetore, <https://kk.rks-gov.net/decan/wp-content/uploads/sites/9/2022/09/Njoftim-Debat-Publik-per-Projekt-Buxhetin-2023-25-Granti-per-Arsim.pdf>



Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në dëgjimet buxhetore i disaagreguar në baza gjinore



Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, në të shumtën ishin pjesëmarrës në këto dëgjime buxhetore. Mirëpo, interesim për të qenë pjesë e dëgjimeve buxhetore kishin edhe anëtarë tjerë të kuvendit të komunës së Deçanit. Kuvendi i komunës si bartëse e procesit të organizimit të dëgjimeve buxhetore në bashkëpunim me ekzekutivin e komunës, në fund të procesit të organizimit të dëgjimeve buxhetore, e ka përpiluar një Raport përmbledhës nga këto dëgjime buxhetore, si dhe ju është dërguar raporti i tillë edhe anëtarëve të Kuvendit të komunës. Mirëpo, raporti i tillë nuk specifikon⁵⁹ në tërësi procesin e organizimit të dëgjimeve buxhetore, me theks të veçantë nuk trajton statusin e kërkesave të parashtruara nga ana e qytetarëve dhe grupeve të ndryshme qytetare, dhe si i tillë nuk përmbushë

kriteret që specifikohen me Udhëzimin Administrativ për Standardet minimale të konsultimit publik në komuna. Po ashtu, raporti i tillë nuk është publikuar në rubrikën adekuate në ueb faqen e komunës, konkretisht tek linku i takimeve publike. Ajo çka mbetet pozitive në kuadër të organizimit të dëgjimeve buxhetore nga komuna e Deçanit, është publikimi i procesverbaleve nga organizimi i dëgjimeve buxhetore gjatë muajit shtator 2022⁶⁰.

Cilat janë kërkesat dhe natyra e kërkesave të dala nga dëgjimet buxhetore



⁵⁹ Shih raportin përmbledhës të organizimit të dëgjimeve buxhetore, <https://kk.rks-gov.net/decan/wp-content/uploads/sites/9/2022/10/Raporti-permbledhesh-i-degjimeve-buxhetore-per-vitin-2023.pdf>

⁶⁰ Shih procesverbalin e njërës nga organizimi i dëgjimeve buxhetore: <https://kk.rks-gov.net/decan/wp-content/uploads/sites/9/2022/09/Procesverbal-Diskutimi-Publik-me-Krijues-Letrar-Artiste-Skenik-dhe-Muzikor-Sportise-etj-per-Projekt-Buxhetin-2023-25.pdf>





4. REKOMANDIMET PËR KOMUNA

- Komunat si: Prishtina, Mitrovica e Jugut⁶¹, Skenderaj dhe ajo e Deçanit⁶² duhen të përpilojnë dhe publikojnë Raportin e organizimeve të dëgjimeve buxhetore sipas specifikave të kërkuara me Udhëzimin Administrativ për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në komuna derisa komuna e Ferizajt dhe Kaçanikut duhet të publikoj në ueb faqe brenda afatit ligjor raportin e organizimit të dëgjimeve buxhetore.
- Ekzekutivi i komunës së Ferizajt, Skenderajt, Rahovecit dhe Kaçanikut, duhen të praktikojnë dërgimin e Raportit nga organizmi i dëgjimeve buxhetore si pjesë e materialit mbështetës për pikën e rendit të ditës për projekt buxhetin e komunës.
- Ekzekutivi i komunës së Skenderajt dhe Deçanit duhen të përmbush obligimeve ligjore në procesin e planifikimit të buxhetit komunal duke siguruar organizimin e dëgjimeve buxhetore gjatë muajit korrik- gusht para se të dorëzohet tek kuvendin e komunës.
- Kuvendi i komunës së Prishtinës, Kamenicës dhe Skenderajt duhet të jetë pjesë e planifikimit të buxhetit duke respektuar dispozitat ligjore të ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit, duke organizuar së paku një dëgjim buxhetor me qytetarë gjatë muajit shtator përkatësisht pas dorëzimit të projekt buxhetit nga ana e kryetarit tek kuvendi i komunës.
- Anëtarët e kuvendit të komunave të Prishtinës, Prizrenit, Ferizajt, Mitrovicës së Jugut, Skenderajt, Rahovecit, Kaçanikut, Kamenicës dhe të Deçanit, duhet të angazhohen më shumë në nxitjen dhe mobilizimin e qytetarëve për të marrë pjesë në organizimet e dëgjimeve buxhetore nga ekzekutivi i komunës. Ky angazhim, në një rëndësi anë do të siguronte një proces transparent të organizimit të dëgjimeve buxhetore dhe në anën tjetër kuvendi do të siguronte llogaridhënie më të madhe nga ekzekutivi sa i përket kërkesave të qytetarëve të dhëna gjatë dëgjimeve buxhetore.
- Të ofrohen mundësi alternative të përfshirjes së qytetarëve në planifikimin e buxhetit komunal. Komuna e Kamenicës, Skenderajt, Mitrovicës së Jugut dhe ajo e Prishtinës janë në mesin e komunave që nuk kanë ofruar mundësi për qytetarët për të dhënë komente dhe sugjerime për projekt buxhetin e komunës duke mos ofruar në dispozicion email adresa zyrtare për qytetarët.

61 Raporti i përpiluar dhe publikuar nga komuna e Mitrovicës së Jugut nuk i përmban elementet përmbajtësore të cilat kërkohen me Udhëzimin Administrativ për standardet minimale të konsultimit publik në nivel lokal

62 Raporti i përpiluar dhe publikuar nga komuna e Deçanit nuk i përmban elementet përmbajtësore të cilat kërkohen me Udhëzimin Administrativ për standardet minimale të konsultimit publik në nivel lokal





- Ekzekutivi i komunës së Prishtinës, Kaçanikut, Mitrovicës së Jugut, Skenderajt dhe i Deçanit duhet të formalizoj me vendim grupin Punues për planifikimin e projekt buxhetit të komunës. Mungesa e formalizimit të grupit punues me vendim shpërfaqë mungesën e respektimit të legjislacionit në fuqi si dhe mungesën e koordinimit ndërinstytucional sidomos në përpilimin e Raportit nga organizimet e dëgjimeve buxhetore, ku si kompetent në hartimin e këtij raporti mbetet grupi punues.
- Ekzekutivi i komunës të dërgoj raportin e dëgjimeve buxhetore tek kuvendi i komunës. Gjatë procesit të monitorimit të organizimit të dëgjimeve buxhetore, përjashtuar komunën e Prizrenit dhe Kamenicës janë shtatë (7) komuna të cilat nuk e kanë dërguar raportin e konsultimit publik (dëgjimit buxhetor) tek kuvendi i komunës.
- Komuna e Prizrenit duhet të respektoj parimin e respektimi të gjuhëve zyrtare në nivel lokal, duke u mundësuar qytetarëve përkthim adekuat gjatë mbajtjes së dëgjimeve buxhetore. Në dëgjimet buxhetore të organizuara në dy lokalitete, ku pjesëmarrës ishin edhe anëtarë të komunitetit boshnjak, komuna nuk ka ofruar përkthim dhe material përcjellës në gjuhët tjera zyrtare (boshnjake).





5. BURIMET

Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi (IDRA). Udhërrëfyes për përfshirjen e qytetarëve / komuniteteve në qeverisjen vendore.

Instituti Demokratik I Kosovës (KDI). Buxheti me pjesëmarrje – Sfidat edhe mundësitë e praktikave të mira të buxhetimit me pjesëmarrje në qeverinë lokale në Kosovë.

Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-48 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116, Nr.04/L-194 dhe Nr.05/L-063.

Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2020 për transparencë në komuna.

Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna.

Ueb faqja zyrtare e Komunës së Prishtinës, <https://kk.rks-gov.net/prishtine/>

Ueb faqja zyrtare e Komunës së Prizrenit, <https://kk.rks-gov.net/prizren/>

Ueb faqja zyrtare e Komunës së Ferizajt, <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/>

Ueb faqja zyrtare e Komunës së Mitrovicës së Jugut, <https://kk.rks-gov.net/mitrovceejugut/>

Ueb faqja zyrtare e Komunës së Rahovecit, <https://kk.rks-gov.net/rahovec/>

Ueb faqja zyrtare e Komunës së Kamenicës, <https://kk.rks-gov.net/kamenice/>

Ueb faqja zyrtare e Komunës së Skenderaj, <https://kk.rks-gov.net/skenderaj/>

Ueb faqja zyrtare e Komunës së Kaçanikut, <https://kk.rks-gov.net/kacanik/>

Ueb faqja zyrtare e Komunës së Deçanit, <https://kk.rks-gov.net/decan/>





Aleanca Qytetare për Transparencë (AQT) është themeluar në vitin 2020, në përbërje të disa organizatave lokale duke përfshirë: OJQ Mundësia, OJQ Fortesa, OJQ IQS, OJQ SHIP, OJQ FOJK si dhe KDI. AQT gjatë vitit 2021 është plotësuar edhe me anëtarë të rinj për të mbuluar komunat e rajonit të Prishtinës (Initiative for Social Education - ISEP), komunat e rajonit të Ferizajt (OJQ Avonet), komuna e rajonit të Gjakovës (SHL-Kosova), komunat e rajonit të Prizrenit (OJQ Sofra). AQT ka për synim të avokoj dhe llojoj tek institucionet lokale dhe qendrore në rritjen e transparencës, përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien institucionale.

Me përkrahjen financiare të:

